Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 12/17
Datë/Datum. 20.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH Nr. 12/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Goran Milenkovic- Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "PBC" me seli në Prishtine, kundër AK–KK Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk", me nr prok: "616 16 144 121", më datën 13 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "PBC" me seli në Prishtine me nr protokolli 12/17, kundër vendimit të AK- KK Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk", me nr prok: "616 16 144 121".

II. **Obligohet,** AK- KK Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk", me nr prok: "616 16 144 121", të bëjë vazhdimin e afatit për ofertim konform nenit 53 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 7 të LPP-së.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin

shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues "PBC" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është pjesërisht e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "PBC"- Prishtinë, me datën 14. 01. 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 12/17, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk" me nr. të Prokurimit: 616 16 144 121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtine. Duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 7 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 28 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 53 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 108/A i ligjit për Prokurim Publik
- Paragrafin e 8'të të nenit 118 të ligjit për Prokurim Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertet shqyrtues në raportin e ekspertizës i kanë rekomanduar panelit shqyrtues qe procedura e prokurimit me titull: "Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e

dokumenteve te gjendjes civile– E Kiosk", me nr. të Prokurimit: 616 16 144 121, të ANULOHET, dhe të ri-tenderohet nëse AK, ka ende interes për të, ndërsa ankesa e OE "PBC", shpk të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Me datë 06. 02. 2017 përmes parashtresës me shkrim AK-KK Prishtinë njofton panelin se nuk pajtohen me raportin dhe mendimin e ekspertëve.

Ndërsa me datë 03. 02. 2017 OE "PBC" njofton panelin se pajtohet pjesërisht me raportin dhe mendimin e ekspertëve.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13 shkurt 2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i eksperteve të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE "PBC"- Prishtinë deklaroj: "*Pretendimet tona ankimore dhe provat janë dhënë në ankesë. Kjo procedurë ka filluar në muajin Mars 2016, dhe prej asaj kohe AK vetëm ndërron format e shkeljes së legjislacionit në fuqi dhe mbetet kategorik në insistimin që këtë kontratë t'ia delegoj kompanisë "DLD Group". Krejt këto sjellje tjera jo adekuate kundrejt ekonomisë së lirë, konkurrencës dhe qëllimit të LPP-së, AK përkatësisht njësia kërkesës i aplikon forma për të arritur qëllimin që këtë kontratë ta destinoj te kjo kompani. Prandaj lus panelin shqyrtues ta trajtoj seriozisht këtë situatë dhe të merr vendim në përputhje me provat dhe legjislacionin në fuqi*".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KK Prishtinë ka deklaruar: "*AK konfirmon edhe njëherë se gjitha pretendimet e OE ankues janë të pabaza. Kjo për faktin se gjatë kësaj procedurë te OE ankues ka bërë kërkesë për sqarime, ne si AK në pajtim me ligjin dhe afatet ligjore kemi bërë tri here vazhdim të afatit, vetëm e vetëm për ti kthyer përgjigje këtij OE. Kjo procedurë ka qenë edhe njëherë në OSHP dhe OSHP ka marr vendim. Ne si AK jemi munduar dhe kemi respektuar atë vendim dhe kemi bërë korrigjim të specifikave dhe i kemi dërguar gjithë OE-ve që kanë konkurruar që nga fillimi procedurës. Gjatë korrigjimit kemi pas kërkesa për informata shtesë dhe i jemi përgjigjur gjithë OE. Sa i përket kërkesës për rishqyrtim herën e fundit ne si AK ka qenë fillimi i vitit, ju e dini se ka pas shumë kërkesa, dhe një përgjigje na është kthyer automatike e OE dhe jo që kemi kundërshtuar këtë, mirëpo kërkesën për rishqyrtim ne si AK nuk e*

kemi pa. Kur OE ka ardhur tek zyrat tona, në konsultim me udhëheqësin e Prokurimit i kemi kthyer përgjigje, me qenë se për të nxjerr vendim ka qenë vonë. Ne kemi bërë hapjen e ofertave, por do kërkoja nga paneli të na lejoj të vazhdojmë procedurën me ata OE që kanë dorëzuar ofertat pasi kjo është procedurë e vjetër tani dhe është në interes të qytetarëve të përfundoj".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: "*Arsyeja pse kemi rekomanduar anulim, është se OE ankues me 04. 01. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim përmes shkresës elektronike, po ashtu me 08. 01. 2017, ka përsëritur kërkesën për rishqyrtim. Sipas shkresave të AK-së nuk është nxjerr ndonjë vendim kundrejt këtyre kërkesave. Veprimi tillë paraqet shkelje nenit 108/A të LPP si dhe të shkelje nenit 8 par. 2 të rregullave për parashtrim të kërkesës sipas legjislacionit sekondar*".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit teknik i cili deklaroj: "*Sa i përket pretendimeve teknike për këtë aktivitet, konsideroj se janë të pabazuara për faktin se AK ka bërë modifikimin e dosjes, specifikave teknike konform vendimit të OSHP duke eliminuar gjitha ato pjesë për vendimin paraprak. Si dëshmi janë specifikat e dosjes të modifikuara nga AK. Specifikat e ndryshuara/modifikuara nga AK janë në pajtim me vendimin e OSHP-së*".

Në mbytjen ne anëtarit te panelit drejtuar përfaqësuesit te AK se ka dorëzuar ofertë OE ankues, në përgjigje deklaroj: "*JO, me sa di unë OE "PBC" nuk ka dorëzuar ofertë*".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "*Duhet të theksoj para panelit se informatat shtesë nuk na janë kthyer, por tek ne ka ardhë një përgjigje e AK-së e cila ka qenë prej procedurës paraprake, ku përgjigjet nuk përkojnë me pyetjet tona. Po ashtu ritheksoj se tri here kemi dërguar kërkesë për shqyrtim në kuadër të afateve ligjore, mirëpo AK fare nuk e ka trajtuar atë kërkesë, dhe këtu deklarohet se nuk e kanë pranuar mirëpo ne kemi provë se kemi dërguar. Lidhur me përgjigjen automatike që përmendi AK, ajo në asnjë variant nuk përkthehet në çfarëdo materiali në procesin e shqyrtimit të kësaj ankese. Ndërsa për prezantimin e pajisjes siç është kërkuar, në dosjen e tenderit që ne kemi pas kërkohet në mënyrë eksplicite, e që është në kundërshtim me vendimin paraprak të AK. Ndërsa kanë bërë ndonjë modifikim dhe kanë dërguar tek ekspertët ajo është shumë e habitshme. I propozojmë panelit që të aprovoj ankesën tonë dhe lënda të kthehet në Ritender pasi neve na është mohuar e drejta shqyrtimit të pretendimeve por edhe dorëzimit të ofertës*".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK- KK Prishtinë deklaroj: "*Ne nuk pajtohemi se nuk i jemi përgjigjur OE për informata, dhe jemi përgjigjur në çdo kërkesë, andaj kemi bërë edhe vazhdimin e afatit tri here. I propozoj panelit që të lejoj AK vazhdimin e me këtë aktivitet të prokurimit*".

Paneli shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lëndës, deklarimeve në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatuar se AK- KK Prishtinë nuk ka respektuar nenin 53, paragrafi 4 të LPP-se, pasiqë nuk i është përgjigjur kërkesave për sqarime shtesë të OE ankues të bëra me datën 03 dhjetor 2016, andaj konform nenit 53 paragrafi 9 përkitazi me paragrafin 7 të LPP-së, autoriteti kontraktues obligohet të zgjasë afatin për ofertim.

Paneli shqyrtues, po ashtu ka konstatuar se AK- KK Prishtinë ka vepruar në kundërshtim me nenin **108/A** të LPP-së, si dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave te ankesave, duke mos i'u përgjigjur me vendim në formë të shkruar dhe të arsyetuar kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 10 dhjetor 2016.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna e Prishtinës"

1x1 OE – "PBC"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.